



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Departamenti për Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr. 62/2021

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Adnan Isufi, kryesues, znj. Diellza Hoxha dhe z. Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat z. [] si organ përmbarues i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës (tash e tutje Ministria e Drejtësisë) për Territorin e Gjykatës Themelore në [] pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike në të cilën prezantuan përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, Znj. Fadilete Hoxha, në cilësi të iniciuesit të procedurës disiplinore, të përmbaruesit privat, z. [] dhe pas seancës këshillimore, me datën 28.01.2022, me shumicë votash, mori këtë:

V E N D I M

- I. Organi përmbarues - Përmbaruesi Privat, z. [] i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në [] është përgjegjës për shkelje disiplinore nga neni 367 par 1, pika 1.2, të LPP-së.
- II. Për kryerjen e kësaj vepre disiplinore, përmbaruesi privat, z. [] i shqiptohet masa disiplinore “vërejtje” e paraparë me nenin 368 par 1, pika 1.1, të LPP-së.

A R S Y E T I M

Me datën 08.09.2021, pala ankuese znj. [] dhe z. [] kanë paraqitur ankesë në Ministrinë e Drejtësisë - Departamentin për Profesione të Lira, Divizionin për Noterinë dhe Përmbarimin Privat ndaj përmbaruesit privat z. [] Pala ankuese pretendon se përmbaruesi privat z. [] ka vepruar njëanshem dhe në mënyrë jo profesionale duke hezituar të lirojë pronën nga njerëzit dhe sendet sipas Aktgjykimit me nr P. nr 201/2017, datës 16.08.2019 të nxjerrë nga Gjykata Themelore në [] Pas pranimit të ankesës, Divizioni për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë së Punës së Profesioneve të Lira ka analizuar pretendimet ankimore dhe me datën 15.12.2021 ka përgatitur raportin e inspektimit të veçantë përkitazi me lëndën

përmbare P. nr 54/2021. Raporti thekson që përmbareu privat z. [] ka cenuar dispozitat e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbareu në këtë lëndë duke mos ndërmarrë veprime për lirim e objektit nga njerëzit dhe sendet sipas vendimit gjyqësor. Sipas raportit, pala debitore z. [] është shpallur fajtor për uzurpim të paligjshëm të pronës me nr UL-70705929-00440. I njëjti bashkë familjen e tij urdhërohet ta kthej pronën e uzurpuar pronarit legjitim - palës kreditore. Raporti thekson që objekt i trajtimit nga përmbareu privat në këtë rast do të duhej të ishte liri i pronës sepse ekziston edhe Aktgjykimi C. nr 700/13 i datës 02.02.2017 i nxjerrë nga Gjykata Themelore në [], ku ndër të tjera është aprovuar kërkesa e paditëses - palës së dëmtuar zri. [] nga [] në tërësi si e bazuar dhe se janë detyruar të paditurit z. [] znj. [] dhe z. [] që të tre nga [] që t'ia lirojnë paditëses nga personat dhe plaçkat paluajtshmërinë e evidentuar si ngastër kadastrale me numër P-70705029-01179-1, shtëpia në sipërfaqe prej 20 m2, oborr me sipërfaqe 106 m2, në të përgjithshme 126 m2. Rrjedhimisht, pronën në fjalë kanë qenë të obliguar që, përveç palës z. [] ta lirojnë edhe nëna e tij z. [] dhe vëllai i tij z. [] Raporti vjen në përfundim që përmbareu privat z. [] ka vepruar në kundërshtim me Ligjin Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbareu, konkretisht nenin 22, nenin 22 par 1, nën par 1.1 dhe nenin 24.

Me datën 17.12.2021, Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesionet e Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbareu Privat, pas shqyrtimit të çështjes ka paraqitur në Komisionin Disiplinor Raportin Përfundimtar ndaj përmbareut privat z. [], si organ përmbareu i emëruar nga për Territorin e Gjykatës Themelore në [] lidhur me veprimet përmbareu në lëndën P. nr 54/2021.

Përmbareu privat në përgjigjen e tij me shkrim deklaron që ka vepruar në pajtim me ligjin dhe autorizimet ligjore. Thekson se përmbareu është lejuar me Urdhrin P. nr 54/21 të datës 09.02.2021, në bazë të Aktgjykimit Penal, i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm i evidentuar me P. nr 201/2017, datës 16.08.2019. Përmbareu privat z. [] thekson që duke u nisur nga natyra e detyrimit që rrjedh nga Aktgjykimi Penal, konsideron që detyrimi është subjektiv dhe ka të bëjë vetëm me personin e dënuar dhe se detyrimi penal nuk mund të shtrihet edhe në persona tjerë të cilën nuk janë gjetur fajtor. Shton që Aktgjykimi penal i referohet edhe Aktgjykimit civil C. nr 700/2013, i datës 02.02.2017, mirëpo ky Aktgjykim nuk është dokument përmbareu në këtë çështje përmbareu, nuk është prezantuar asnjëherë nga kreditorët për zbatim as në këtë procedurë dhe organi përmbareu me asnjë shkresë nuk është njoftuar për ekzistimin e këtij aktgjykimi apo plotfuqishmërinë e tij. Përmbareu privat thekson që sipas kërkesës së palës kreditore procedura përmbareu ka vazhduar ashtu që me dt 28.07.2021, është nxjerr konkluzioni për daljen në vend. Përmbareu privat personalisht ka hyrë në hapësirat e brendshme të shtëpisë që është objekt i përmbareut dhe personalisht është bindur se pala debitore z. Spahija nuk ndodhet në shtëpi, se aty banojnë nëna e tij, znj. [] dhe vëllai i tij, z. [] i moshës madhore, se një veturë e parkuar para shtëpisë nuk është e debitorit dhe se faturat për detyrime komunale nuk evidentohen në emër të debitorit. Përmbareu privat thekson që është konstatuar dhe është vërtetuar se debitori është larguar dhe nuk banon në këtë shtëpi duke zbatuar kështu detyrimin e tij që rrjedh nga dokumenti përmbareu. Përmbareu privat z. [] vjen në përfundim që sipas dokumentit përmbareu pala debitore nuk mund të detyrohet që të largojë dhunshëm familjarët e rritur nga shtëpia me qëllim që objektin t'ia dorëzojë palës kreditore pasi që nëna dhe vëllai madhor janë përgjegjës për veprimet e veta dhe nuk i nënshtrohen

vullnetit të familjarëve tjerë dhe se të njëjtit sipas dëshirës së tyre kanë vazhduar të jetojnë në objektin e njëjtë. Përmbaruesi privat z. [] thekson që me datën 31.08.2021 është nxjerrë urdhri për përfundimin e procedurës përmbarimore dhe pala kishte mundësinë e shfrytëzimit të mjetit juridik përkatësisht paraqitjes së ankesës për mënyrën e vendosjes nga organi përmbarimor, përkatësisht përmbaruesi privat.

Me datën 28.01.2022, Komisioni ka mbajtur seancë dëgjimore në të cilën kanë marr pjesë përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj. Fadilete Hoxha, në cilësi të iniciuesit të procedurës disiplinore dhe përmbaruesi privat, z. []

Përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj. Fadilete Hoxha, ka bërë shtjellimin e Raportit përfundimtar ndaj përmbaruesit privat duke theksuar se mbetet pranë tij. Po ashtu, përmbaruesi privat z. [] ka paraqitur qëndrimin e tij lidhur me pretendimet e ngritura dhe ka kërkuar refuzimin e tij.

Komisioni Disiplinor me kujdes, vëmendje të veçantë dhe në mënyrë shteruese ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, vjen në përfundim se përmbaruesi privat z. [] ka kryer shkelje disiplinore.

Komisioni Disiplinor fillimisht nënvizon rëndësinë e veprimit të organit përmbarues brenda kornizave të dokumentit përmbarues. Veprimi jashtë kornizave cënon ligjshmërinë, sigurinë juridike, rrjedhimisht edhe të drejtat e palëve në procedurën përmbarimore. Prandaj, është e rëndësishme që aktvendimi për përmbarim apo urdhri për përmbarim të merret brenda kornizave të dokumentit përmbarues dhe përmbarimi të kryhet brenda kufijve të caktuar në aktvendimin për përmbarim apo urdhrin për përmbarim. Në rastin konkret, dokument përmbarues ishte Aktgjykimi Penal i lëshuar nga Gjykata Themelore në [] - Departamenti i Përgjithshëm P. nr 201/2017 dt 16.08.2019. Sipas këtij aktgjykimi, z. [] ishte gjetur fajtor për veprën penale-Uzurpim i Paligjshëm i Pronës së Paluajtshme, nga neni 332 par 1, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Ky Aktgjykim, mes tjerash, urdhëron të pandehurin z. [] që “ të kthejë pronën e paluajtshme të uzurpuar, e cila gjendet në rrugën [] dhe atë ngastrën kadastrale me nr P-70705029-01179-1, me kulturë shtëpi-ndërtesa në sipërfaqe prej 20 m2, oborr në sipërfaqe prej 106 m2, e në sipërfaqe të përgjithshme prej 126 m2, Zona Kadastrale [], e cila evidentohet sipas Certifikatës mbi të drejtat e pronës së paluajtshme me numër UL-70705929-00440, prona e paluajtshme të i dorëzohet të dëmtuarës [].” Propozimi për përmbarim, përkatësisht, Urdhri për përmbarim P. nr 54/21 dt 09.02.2021, përmban të njëjtin formulim pa ndryshime. Rrjedhimisht, pavarësisht që Aktgjykimi Penal mbi bazën e së cilit ishte zbatuar përmbarimi nuk kërkon lirimin e paluajtshmërisë nga “njerëzit dhe sendet” sepse i referohet ekskluzivisht të pandehurit z. [] i njëjti përcakton dy detyrime për organin përmbarimor: së pari, të obligohet i pandehuri – pala debitore z. [] që ta liron pronën e paluajtshme dhe së dyti, që prona e paluajtshme të dorëzohet të dëmtuarës – kreditores []. Në rastin konkret, përmbaruesi privat z. [] ishte siguruar që i pandehuri z. [] kishte liruar pronën e paluajtshme. I pandehuri z. [] në fakt, nuk ndodhej fare aty me rastin e daljes në vendin e ngjarjes. Rrjedhimisht, organi përmbarimor kishte

përbushur përbarimin për sa i përket largimit të pandehurit – palës debitore nga prona e paluajtshme. Megjithatë, Komisioni Disiplinor gjen se përbaruesi privat nuk kishte përmbushur përbarimin sipas dokumentit përbarues përkatësisht urdhrin përbarimor për sa i përket dorëzimit të paluajtshmërisë palës debitore. Pjesa lidhur me dorëzimin e paluajtshmërisë në fjalë palës debitore, në fakt, ishte pjesa më e rëndësishme. Në procesverbalin i cili gjendet në shkresat e lëndës është konstatuar “meqë palët nuk [palexueshme] zgjidhje me marrëveshje, përbarimi nuk mund të vazhdohet.” Megjithatë, në vlerësimin e Komisionit Disiplinor, nuk kishte asnjë pengesë në realizimin e përbarimit. Duke mos realizuar përbarimin në mënyrë të plotë, palës debitore i është pamundësuar dhe apo vështirësuar në masë të konsiderueshme realizimi i të drejtës së saj sipas dokumentit përbarues të marrjes në posedim të paluajtshmërisë. Rrjedhimisht, Komisioni Disiplinor vjen në përfundim që përbaruesi privat z. [Emri i personit] nuk ka vepruar konform dispozitave ligjore.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e masës disiplinore, Komisioni Disiplinor kishte parasysh rrethanat e rastit konkret dhe veçanërisht faktin se ndaj përbaruesit privat z. [Emri i personit] nuk është shqiptuar masë tjetër disiplinore. Komisioni Disiplinor vlerëson se masa e shqiptuar disiplinore i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë disiplinore të përbaruesit privat z. [Emri i personit], është e mjaftueshme dhe në përputhshmëri me karakteristikat rastit konkret si dhe në pajtim me parimin e proporcionalitetit, dhe i njëjti do të ndikojë në përbaruesin si dhe tek përbaruesit tjerë që t’u përmbahen dispozitave ligjore në përmbushjen e mandatit ligjor në ofrimin e shërbimeve përbarimore në mënyrë profesionale dhe objektive, çka, në thelb, është edhe qëllimi i masës disiplinore.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT
DPL.nr 62/2021, datë 28.01.2022

Kryesues i Komisionit Disiplinor
Adnan ISUFI



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrative bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.